



**KONTRATË SHITBLERJE TË KUOTAVE TË KAPITALIT  
THEMELTAR TË SHOQËRISË "T.TICKET "SH.P.K**

Sot më date 17/12 2021, palët nënshkruajnë këtë kontratë shiblerje kuotash:

**SHITËSIT**

**Z.Sokol Qeraxhiu**, i lindur më 16.05.1971, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.H10516142M, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**Z.Genci Likoskendaj**, i lindur më 16.02.1969, në Fier dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.G90216145T, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**Z.Ervis Hila**, i lindur më 04.07.1981, në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.I10704065R, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**BLERËSIT**

**Z.Arben Gjoshi**, i lindur më 10.09.1980, në Lezhë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.I00910123H, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**Z.Kujtim Llupa**, i lindur më 15.03.1975, në Gurë i Bardhë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.H50315249H, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**Z.Naim Dani**, i lindur më 10.06.1968, në Gjorm dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me Nr.G80610217V, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**NENI 1  
KUSHTET E KONTRATËS**

Në lidhjen e kësaj Kontrate ekziston pëlqimi i palëve në marrjen përsipër të detyrimeve përkatëse, shkak i ligjshëm në të cilin mbështeten detyrimet, dhe objekti që formon lëndën e kontratës.

Kontrata quhet e vlefshme meqënëse palët kanë shfaqur dhe shprehur në mënyrë të ndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj.

Në këtë Kontratë, palët shprehin dhe garantojnë që shkak i ligjor i lidhjes së saj nuk është i paligjshëm, nuk vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik si dhe Kontrata nuk shërben si mjet për të shmangur zbatimin e një norme të legjislacionit shqiptar.

### Ekzistojnë këto kushte paraprake

Rezultton se Shoqëria "T.TICKET Sh.p.k" është person juridik shqiptar regjistruar pranë QKB datë 28.09.2015, me NUIS - L52128099A , me kapital themeltar prej 100,00 dhe numër të përgjithshëm kuotash 5,00.

**Shoqëria ka si objekt veprimtarie "Operim, zbatim, dhenie me qera sistemesh per administrimin e shitjeve te biletave dhe platforma online per shitje ne Internet. Shitje biletash per aktivitete sportive, kulturore, etj."**

Ortakët e shoqërisë janë:

1. Z.Ervis Hila i cili zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 16,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 16,00.
2. Z.Arben Gjoshi i cili zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 16,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 16,00.
3. Z.Sokol Qeraxhiu i cili zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 26,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 26,00.
4. Z.Genci Likoskendaj i cili zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 25,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 25,00.
5. Z.Kujtim Llupa i cili zotëron 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 17,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 17,00.

Në datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021, Ortakët e Shoqërisë "T.TICKET" Sh.p.k", Z.Ervis Hila, Z.Genci Likoskendaj dhe Z.Sokol Qeraxhiu, kanë vendosur shitjen e kuotave të kapitalit themeltar që përfaqësojnë në Shoqëri, Ortakëve Z.Arben Gjoshi, Z.Kujtim Llupa si dhe blerësit Z. Naim Dani.

### **NENI 2**

#### **QËLLIMI I KONTRATËS**

Qëllimi i kësaj Kontrate është transferimi i pronësisë kundrejt pagesës, të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "T.TICKET" Sh.p.k., që zotërojnë Shitësit, në favor të Blerësve.

Kjo Kontratë shërben për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe mënyrave të transferimit të kësaj pronësie, si dhe pagesat përkatëse në lidhje me këtë transferim.

Me anë të këtij veprimi juridik të dyanshëm, palët synojnë të krijojnë një marrëdhënie juridike ndërmjet tyre, e cila mbështetet në parimet e ndërshtëmërisë, ligjshmërisë dhe besimit reciprok ndërmjet palëve.

Në përcaktimin e kushteve, Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, dhe angazhohen të kryejnë veprimet e tyre brënda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe nga përmbajtja e kësaj kontrate.

### **NENI 3**

#### **OBJEKTI I KONTRATËS**


Objekti i kësaj Kontrate është i mundshëm, i ligjshëm, dhe i përcaktueshëm nga Palët nëpërmjet kësaj Kontrate, si dhe konsiston në Kuotat e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë Tregtare "T.TICKET" Sh.p.k., kundrejt vlerës së shitjes së tyre.

Objekti i kësaj kontrate është transferimi i kuotave nëpërmjet kontratës së shitjes të:


- Z. Ervis Hila shet 8 % të kapitalit themeltar të shoqërisë palës blerëse Z.Naim Dani.
- Z. Ervis Hila shet 8 % të kapitalit themeltar të shoqërisë palës blerëse ortakut Z.Arben Gjoshi.
- Z. Genci Likoskendaj shet 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë palës blerëse ortakut Z.Kujtim Llupa.
- Z. Sokol Qeraxhiu shet 11 % nga 26 % të kapitalit themeltar të shoqërisë palës blerëse ortakut Z.Arben Gjoshi.

Shitësit kanë të drejtë të plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe posedimit të kuotave të kapitalit të shoqërisë tregtare "T.TICKET sh.p.k"

Shitësit transferojnë pjesët takuese të kapitalit të zotëruara prej tyre sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, duke dorëzuar pronësinë dhe posedimin e kapitalit të Shoqërisë "T.TICKET sh.p.k" me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre blerësve.



Fq. 2



#### NENI 4

#### CMIMI I SHITJES SË KAPITALIT DHE MËNYRA E PAGESËS

Vlera e kapitalit themeltar në masën është vlerësuar nga palët si më poshtë vijon:

- 8 % të kapitalit themeltar të shoqërisë me zotërues Z. Ervis Hila shiten palës blerëse Z.Naim Dani në vlerën **66,727.52 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e shtatë pikë pesëdhjetë e dy) Lekë.**
- 8 % të kapitalit themeltar të shoqërisë me zotërues Z.Ervis Hila shiten palës blerëse ortakut Z.Arben Gjoshi në vlerën **66,727.52 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e shtatë pikë pesëdhjetë e dy) Lekë.**
- 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë me zotërues Z.Genci Likoskendaj shiten palës blerëse ortakut Z.Kujtim Llupa në vlerën **208,523.50 (dyqind e tetë mijë e pesëqind e njëzetë e tre pikë pesëdhjetë) Lekë.**
- 11 % nga 26 % të kapitalit themeltar të shoqërisë me zotërues Z.Sokol Qeraxhiu shiten palës blerëse ortakut Z.Arben Gjoshi në vlerën **91,750.34 (nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë pikë tridhjetë e katër) Lekë.**

Cmimet e shitjes të sipërcituara do të likujdohen në llogaritë bankare të shitësve me të dhënat si më poshtë vijon:

**1. Ervis Hila**

Nr. Llogarisë: AL8520511258002209CLIDCLALLV

Banka : Banka Kombëtare Tregtare

**2. Genci Likoskendaj**

Nr. Llogarisë: AL8920511258044766CLIDCLALLE

Banka : Banka Kombëtare Tregtare

**3. Sokol Qeraxhiu**

Nr. Llogarisë: AL7520511258287543CLIDCLALLR

Banka : Banka Kombëtare Tregtare

#### NENI 5

#### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISE SË KAPITALIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala shitëse :

Z. Ervis Hila humbet plotësisht 16 % të drejtën e pronësisë mbi shoqërinë "T.TICKET sh.p.k" duke njohur plotësisht me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ortakët e shoqërisë Z. Naim Dani dhe Arben Gjoshi.


Z. Genci Likoskendaj plotësisht humbet 25 % të drejtën e pronësisë mbi shoqërinë "T.TICKET sh.p.k" duke njohur plotësisht me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ortakun Z.Kujtim Llupa.

Z. Sokol Qeraxhiu humbet pjesërisht 11 % të drejtën e pronësisë mbi shoqërinë "T.TICKET sh.p.k" duke njohur plotësisht me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ortakun e shoqërisë Z.Arben Gjoshi.

Transferimi i kuotave nga palët shitëse tek palët blerëse bëhet në vlerën e tyre respektive nominale dhe palët blerëse përmes fitimit të pronësisë së kuotave respektive fitojnë cdo të drejtë ligjore si dhe marrin përsipër cdo detyrim në vlerën e kuotës që ata përfitojnë në shoqërinë "T.TICKET sh.p.k"

#### NENI 6

#### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHITËSIT



Shitësit morën përsipër të njoftojnë, garantojnë dhe sigurojnë Blerësit se deri në momentin e lidhjes dhe nënshkrimit të Kontratës këto kuota:

- Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësorë
- Nuk janë të bllokuara për llogari të të tretëve , se kuotat objekt shitje janë plotësisht të lira nga cdo barrë, detyrim , të drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër
- Shitësit janë pronar ligjorë dhe nuk kanë persona të tjerë që mund të kenë pretendime në lidhje me këto kuota.
- Dokumentacioni i bashkalidhur kësaj kontrate janë origjinale, ligjore dhe nuk janë marrë në rrugë të kundraligjshme.
- Nuk kanë asnjë kontratë të lidhur më përpara e cila të ketë ndikim drejtëpërdrejtë mbi pronësinë mbi këto kuota.
- Shitësit nuk kanë detyrime të papaguara në favor të të tretëve dhe se shoqëria nuk ka detyrime financiare të pushlyera apo aq më tepër të padeklaruara ndaj të tretëve, përvec atyre të deklaruara në pasqyrat financiare të shoqërisë që i janë bërë të ditura palës blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate;

Shitësit janë të detyruar të paguajnë detyrimet në shoqëri dhe ndaj shtetit deri në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje kuotash. Pas këtij momenti detyrimet e tjera mbulohen nga Blerësit.

#### **NENI 7 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BLERËSIT**

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate, Blerësit do paguajnë cdo lloj takse mbi kapitalet që ata zotërojnë në shoqëri, detyrimet ndaj të tretëve , shtetit etj.

Blerësit kanë të drejtë të sillen si pronar të ligjshëm mbi këto kuota nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kjo kontratë është e detyrueshme edhe për trashëgimtarët, pasardhësit në detyrë të palëve.

#### **NENI 8 PËRBËRJA E SHOQËRISË**

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit struktura e kapitalit të shoqërisë do të jetë sipas tabelës si më poshtë vijon:

<b>ORTAKËT</b>	<b>% NË KAPITALIN E SHOQËRISË</b>
Z. ARBEN GJOSHI	35 %
Z. KUJTIM LLUPA	42 %
Z. NAIM DANI	8%
Z.SOKOL QERAXHIU	15%

Në të njëjtat raporte me përqindjet e kuotave që zotërojnë në shoqëri ortakët marrin përsipër edhe detyrimet sikundër gëzojnë edhe të drejtat sipas Ligjit Nr. 9901/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

#### **NENI 9 EFEKTET E KONTRATËS**

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.  
Kjo kontratë ka forcën e ligjit për palët kontraktuese.  
Kontrata ka efekt ndaj të tretëve dhe subjekteve të tjera sipas parashikimeve të ligjit.

**NENI 10**  
**ZGJIDHJA E KONTRATËS**

Në rastet kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta të parashikuara nga kjo Kontratë, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

**NENI 11**  
**INTERPRETIMI I KONTRATËS**

Në rast se do të lindë e nevojshme të interpretohet kjo Kontratë, atëherë do të sqarohet se cili ka qënë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës.

Kushtet e Kontratës do të interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit të Kontratës. Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët.

**NENI 12**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Blerësit dhe Shitësit angazhohen të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit ndërmjet tyre, problemet do të mundohen të vlerësohen me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Në rast të konflikteve gjyqësore, Gjykata kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 13**  
**TË NDRYSHME**

Ngarkohen palët ose persona të autorizuar prej tyre që të kryejë rregjistrimin e kësaj kontrate në QKB me efekt të ligjshëm nga data e kontratës.

Palët deklarojnë që janë dakort me përmbajtjen e bërë në këtë kontratë dhe se ortakëria e shoqërisë tregtare në vijim do të jetë sipas nenit 8 të kësaj kontrate.

Kontrata redaktohet në 8 ekzemplarë autentik në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike. Secila palë mban nga një ekzemplarë , ndërsa një ekzemplarë depozitohet në QKB sipas ligjit.

Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim për sa më sipër dhe se kanë disponuar me vullnet të lirë ,të plotë dhe të pavesuar.

Pavlefshmëria e pjesëve të vecanta të kësaj kontrate nuk e çënojnë në thelb qëllimin e saj për transferim të kuotave respektive sipas nenit 3 të kësaj kontrate nga shitësit tek pala blerëse.



Fq. 5

Kontratës i bashkangjiten kopje të letërnjoftimeve të palëve shitëse dhe blerëse dhe kopje e ekstraktit të Shoqërisë.

Përfundimisht palët kontraktore , pasi redaktuan bashkarisht këtë kontratë sipas vullnetit të lirë dhe të plotë e lexojnë bashkarisht kontratën dhe pasi e gjejnë në përputhje me qëllimin e tyre si dhe vullnetin e lirë kontraktor , e nënshkruajnë personalisht duke i dhënë fuqi ligjore.

### PALËT KONTRAKTORE

SHITËSIT

Jona Shkodra  
Eda Xereshi  
Kujtim Llopa  
Ervan Hila

BLERËSIT

Arben Gjonu  
Arben Gjonu

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ARDJANA A. MEDIU**



**DATE 17/12/2021  
NR REP 6909**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 17.12.2021, para meje Notere ARDJANA A. MEDIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

**NËNSHKRUESIT:**

**Z.Ervis Hila**, atësia Vladimir, amësia Sabrije, shtetas shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr."Dëshmorët E 4 Shkurtit"; Nd. 40; H. 12; Ap. 6; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 04/07/1981, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 031837538 dhe Nr. Personal I10704065R.

**Z.Sokol Qeraxhiu**, atësia Mehmet, amësia File, shtetasshqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Hodo Beg; Nd. P.156/4; H. Shk.1; Ap. Ap.9; Njësia Administrative Nr. 1; Njesia Bashkiake Nr. 1; 1004; Tiranë, lindur më 16/05/1971, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 035897944 dhe Nr. Personal H10516142M.

**Z.Genci Likoskendaj**, atësia Laver, amësia Farfuri, shtetas Shqiptar, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me adresë Vilave 03910145; Nd. 19; H. 1; Farkë; Lundër; 1045; Tiranë, lindur më 16/02/1969, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 036835772 dhe Nr. Personal G90216145T.

**Z.Kujtim Llupa**, atësia Qazim, amësia Hajrije, shtetas shqiptar, lindur në Guri Bardhe, Burrel dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr."Egnatia"; Nd. 57; H. 1; Njësia Administrative Nr. 11; Njësia Bashkiake Nr. 11; 1026; Tiranë, lindur më 15/03/1975, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 036998230 dhe Nr. Personal H50315249H.

**Z.Arben Gjoshi**, atësia Asllan, amësia Servete, shtetas shqiptar, lindur në Lezhe dhe banues në Tiranë, me adresë P Mima 28/77; Nd. 1845; H. 1; Ap. 103; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 10/09/1980, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033848494 dhe nr. personal I00910123H.

**Z.Naim Dani**, atësia Ali, amësia Nafie, shtetas shqiptar, lindur në Gjorm, Krujë dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr."Don Bosko" Kulla; Nd. 6; H. 1; Ap. 19; Njësia Administrative Nr. 9; Njesia Bashkiake Nr. 9; 1016; Tiranë, lindur më 10/06/1968, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033825878 dhe nr. personal G80610217V.

Të cilët, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Kontratë Shitblerje të Kuotave të Kapitalit Themeltar të Shoqësisë "t.ticket" Sh.p.k, date 17. 12.2021, bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

**ARDJANA A. MEDIU**

ROBERTA E. SHOIFER  
R.D. # 1  
MEDICAL CENTER

1982